REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1614
Data / Datum / Date: 26 / 11 / 2026
Shtojca / Dodaci / Annex -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde – Office of the Minister of Justice

---

Nr. 344 /2026
Datë: 26 / 11 /2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura në përputhje me nenin 10, nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294 për Zyrtaret Publik, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK)-Nr.08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Lulzim Beqiri. Drejtor i Departamentit Ligjor, caktohet ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ushtruesi i detyrës i caktuar në pikë 1 të këtij vendimi, obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij t'i kryejë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

A r s y e t i m

Me vendimin për transferim të përhershëm, z. Ridvan Hoti, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, transferohet në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me qëllim të garantimit të vazhdimësisë së udhëheqjes, forcimit të kapaciteteve menaxheriale dhe sigurimit të funksionimit të rregullt, efikas dhe të pandërprerë të këtij institucioni, duke marrë parasysh rëndësinë e tij për sistemin e drejtësisë dhe natyrën specifike të detyrave dhe përgjegjësive ligjore.

Si rezultat i këtij transferimi, pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë mbetet e lirë, duke paraqitur nevojën për ndërmarrjen e masave të menjëhershme organizative dhe menaxheriale për garantimin e vazhdimësisë institucionale dhe administrative të Ministrisë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm në udhëheqjen dhe koordinimin e administratës së Ministrisë, sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetit administrativ, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, zbatimin e politikave dhe objektivave institucionale, si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, është e domosdoshme të sigurohet ushtrimi i pandërprerë i detyrave dhe përgjegjësive që ndërlidhen me këtë pozitë.

Në këtë drejtim, duke pasur parasysh përvojën profesionale dhe menaxheriale të z. Lulzim Beqiri, Drejtor i Departamentit Ligjor, njohuritë e tij në fushën juridike dhe administrative, njohjen e strukturës organizative, proceseve të punës dhe prioriteteve institucionale të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe përvojën në koordinimin e proceseve ndërdepartamentale, është vlerësuar se caktimi i tij si ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm i shërben garantimit të stabilitetit administrativ, vazhdimësisë institucionale dhe realizimit efektiv të objektivave të Ministrisë.

Për këto arsye, është vlerësuar i nevojshëm caktimi i z. Lulzim Beqiri si ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, deri në plotësimin e kësaj pozite, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, duke marrë parasysh transferimin e përhershëm të Sekretarit të Përgjithshëm, nevojën për garantimin e vazhdimësisë institucionale dhe administrative, si dhe bazën ligjore përkatëse, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Z. Lulzim Beqiri;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*